



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
AGJENCIA E SHËRBIMEVE FUNERALE

RISHPALLJE PËR VEND TË LIRË PUNE

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (të ndryshuar), Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr.3717/2, datë 01.02.2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Shërbimeve Funerale, njësi në varësi të Bashkisë Tiranë” (të ndryshuar), Agjencia e Shërbimeve Funerale rishpall procedurën e konkurimit për vendin e lirë të punës për pozicionin:

1 (një) Varrmihës në Sektorin Tufinë – Klasa e pagës VIII

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

1. Kryen hapjen e varrit vetëm me urdher të përgjegjësit të sektorit dhe në vendin e përcaktuar prej këtij të fundit.
2. Hapja e varrit bëhet sipas KTZ dhe brenda kushteve dhe përmasave të caktuara në rregullat e rregullores teknike për projektimin dhe ndërtimin e varrezave.
3. Për çdo problem që del gjatë hapjes së varrit ndalon procesin e punës dhe njofton menjëherë përgjegjësën e sektorit.
4. Përgjigjet për dëmtimin ose përdorimin e infrastukturës brenda territorit të varrezave si të shesheve rrugëve kryesore apo dytësore për varrime, qoftë edhe me urdhër të përgjegjësit të sektorit.
5. Gjatë punës është i detyruar të mbajë veshjet e punës dhe masat e tjera mbrojtëse.
6. Kryen dizinfektimin e ambjentit pas kryerjes së varrimit.
7. Përgjigjet për çdo veprim hapje-mbyllje varri të kryer pa urdhër të përgjegjësit të sektorit.

1. KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit për pozicionin varrmihës janë:

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë kryer arsimin 8-vjeçar;
- c) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

- d) Të zotërojnë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- e) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- f) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Kërkesë për aplikim (me shkrim dore);
2. Curriculum Vitae (jetëshkrimi);
3. Fotokopje e diplomës së shkollës e noterizuar
4. Fotokopje e kartës së identitetit;
5. Çertifikatë e përbërjes familjare;
6. Fotokopje e librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
7. Motivacioni i largimit nga puna e fundit (nëse është i punësuar ose ka qënë i punësuar);
8. Raport mjeko-ligjor;
9. Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
10. Dy fotografi (përmasa 2.5x3.5 cm)

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në zyrën e protokollit të Agjencisë së Shërbimeve Funerale brenda datës **05 Gusht 2020**.

3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **07 Gusht 2020**, Njësia e Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Shërbimeve Funerale do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e internetit të Agjencisë dhe stendat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e pranimit si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit për pozicionin e lirë të punës dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht (nëpërmjet komunikimit telefonik), për shkaqet e moskualifikimit.

4. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:


Kandidatët do të vlerësohen për përvojën apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe për vlerësimet e rezultateve individuale në punë. Totali i pikëve për këtë vlerësim është **40 pikë**.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën. Totali i pikëve për këtë vlerësim është **60 pikë**.

5. DATA E DALJES SË REZULTATIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Burimeve Njerëzore do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet komunikimit telefonik). Njësia e Burimeve Njerëzore do të shpallë fituesin në faqen zyrtare të Agjencisë, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe stendat e informimit të publikut.



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
AGJENCIA E SHËRBIMEVE FUNERALE

Nr. 640/₃ prot.

Tiranë, më 23.07. 2020

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave të rekrutimit për pozicionin Përgjegjës i varrezave Tufinë

SHËRBIMI KOMBËTAR I PUNËSIMIT

Agjencia e Shërbimeve Funerale në zbatim të Urdhrit nr. 3717/2 prot., datë 01.02.2017 për “Miratimin e strukturës dhe organikës të Agjencisë së Shërbimeve Funerale, njësi në varësi të Bashkisë së Tiranës”, të ndryshuar me Urdhërin nr.7070/1, datë 20.02.2020, sipas të cilit është miratuar pozicioni i punës Përgjegjës i varrezave Tufinë, kategoria e pagës III-b, ju dërgojmë bashkëlidhur kësaj shkrese shpalljen për pozicionin e punës Përgjegjës i varrezave Tufinë.

Ju faleminderit për mirëkuptimin.

DREJTOR



Raimonda Shino



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
AGJENCIA E SHËRBIMEVE FUNERALE

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (të ndryshuar), Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr.3717/2, datë 01.02.2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Shërbimeve Funerale, njësi në varësi të Bashkisë Tiranë” (të ndryshuar), Agjencia e Shërbimeve Funerale shpall procedurën e konkurimit për vendin e lirë të punës për pozicionin:

1 (një) Përgjegjës Varrezash Tufinë – Kategoria e pagës III-b

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

1. Organizon kryerjen e shërbimeve funerale, pastrimin, mirëmbajtjen dhe ruajtjen e varreve dhe varrezave publike.
2. Organizon punën për punonjësit që kanë në varësi, sipas parashikimeve të rregullores.
3. Përgjigjet për çdo shërbim varrimi të kryer pa urdhërin e punës të lëshuar nga sektori ekonomik i institucionit dhe pa verifikuar në sektorin ekonomik kryerjen e pagesës nga agjencia funerale private.
4. Përgjigjen për bazën materiale të furnizuar nga institucioni për mbarëvajtjen e punës në sektor.
5. Përcakton vendin e varrimit, duke përcaktuar qartë numrin e parcelës, të radhës dhe të varrit të të ndjerit dhe orës së kryerjes së varrimit.
6. Organizon dhe bën pritjen e mallrave nga firmat furnizuese kundrejt një procesverballi me komision, duke përcaktuar në të cilësinë, sasinë e vlerën e mallit dhe një kopje të procesverballit ia bashkëlidh faturës tatimore.
7. Përgjigjet për kryerjen e çdo zhvarrimi të të ndjerëve (eshtra) pa marrë miratim nga drejtoria për zhvarrim eshtrash dhe pa kaluar koha e prehjes që parashikon ligji.
8. Përgjigjet për kryerjen e çdo rivarrosje të eshtrave, të ardhura nga rrethet e tjera, pa marrë miratim nga drejtoria për pranim eshtrash.
9. Përgjigjet për kryerjen e çdo rezervim të vendvarrimeve në kundërshtim të ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi për “Administrimin e shërbimit të varrimit” dhe pa miratim të drejtorisë.
10. Përgjigjet për dëmtimin ose përdorimin e infrastukturës brenda territorit të varrezave si të shesheve rrugëve kryesore apo dytësore për varrime.
11. Ndjek konsumimin e materialeve, sipas normativave të miratuara dhe çdo muaj raporton te specialist inxhinier ndërtimi, sektorin ekonomik dhe në drejtori mbi gjendjen e materialeve.

12. Kontrollon plotësimin me korrektësi të Regjistrit të Shërbimit të Varrimit dhe e nënshkruan atë në çdo faqe. Për realizimin e kësaj detyre përgjegjësi i sektorit ka të drejtë të kërkojë nga personat përgjegjës çdo të dhënë që i nevojitet.
13. Kontrollon dhe disiplinon punimet e ndërtimit të varreve që kryhen nga subjektet private brenda territorit të varrezave publike, sipas Ligjit nr.9220, datë 15.04.2004 “Për administrimin e shërbimit të varrimit” (ndryshuar me ligjin Nr.80/2014); Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.711, datë 29.10.2014 “Për miratimin e rregullores “Për administrimin dhe funksionimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë” dhe V.K.M nr.712, datë 29.10.2014 për miratimin e rregullores teknike “Për projektimin dhe ndërtimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë” dhe aktet e tjera nënligjore të dala në zbatim të tij.
14. Urdhëron lëvizjen e mjeteve të transportit të sektorit, sipas nevojave të punës.
15. Kontrollon dhe nënshkruan fletë udhëtimet e drejtuesit të mjetit dhe i paraqet në fund të muajit në drejtori.
16. Kërkon nga drejtuesi i mjetit, që mjeti të jetë në gjendje të sigurt teknike dhe në gadishmëri për zhvillimin normal të aktivitetit të punës në sektor.
17. Kërkon informacion të vazhdueshëm nga tekniku i ndërtimit për harxhimin e bazës materiale në sektor.
18. Përgjigjet për punë të kryera pa miratim nga Drejtoria.
19. Merr masa për sigurimin teknik në punë të punonjësve të sektorit.
20. Organizon shërbimin e ruajtjes së varrezave dhe administron dokumentacionin përkatës të shërbimit të rojes.
21. Plotëson listeprezencën e punonjësve të sektorëve që drejton dhe e paraqet në sektorin ekonomik në datën e fundit të çdo muaji.
22. Përgatit raporte mujore (pasqyra të volumeve të punëve) për të gjithë aktivitetin e kryer në sektor dhe e paraqet në drejtori në fund të çdo muaji.

1. KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit për pozicionin Përgjegjës Varrezash Tufinë janë:

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë kryer arsimin e lartë;
- c) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) Të zotërojnë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- e) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- f) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë minimalisht diplomë të nivelit “Master Profesional” ose Diplomë e barazvlefshme me të sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në shkencat inxhinieri ndërtimi/juridike/ekonomike.
- b) Të ketë përvojë pune jo më pak se 5 (pesë) vjet në profesion;
- c) Përdorues shumë i mirë i paketës MS Office.

2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Kërkesë për aplikim (me shkrim dore);
2. Curriculum Vitae (jetëshkrimi);
3. Fotokopje e diplomës së shkollës dhe lista e notave e noterizuar (përfshirë edhe diplomën bachelor);
4. Fotokopje e kartës së identitetit;
5. Çertifikatë e përbërjes familjare;
6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
7. Fotokopje e librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
8. Motivacioni i largimit nga puna e fundit (nëse është i punësuar ose ka qënë i punësuar);
9. Raport mjeko-ligjor;
10. Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
11. Dy fotografi (përmasa 2.5x3.5 cm).

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në zyrën e protokollit të Agjencisë së Shërbimeve Funerale brenda datës **05 Gusht 2020**.

3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **07 Gusht 2020**, Njësia e Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Shërbimeve Funerale do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e internetit të Agjencisë dhe stendat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e pranimit si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit për pozicionin e lirë të punës dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e moskualifikimit.

4. FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me njohuritë në:

- a. Ligjin nr.9220, datë 15.04.2004 “Për administrimin e shërbimit të varrimit” (ndryshuar me ligjin Nr.80/2014).
- b. Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.711, datë 29.10.2014 “Për miratimin e rregullores “Për administrimin dhe funksionimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë”.
- c. V.K.M nr.712, datë 29.10.2014 për miratimin e rregullores teknike “Për projektimin dhe ndërtimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë”.

5. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe për vlerësimet e rezultateve individuale në punë. Totali i pikëve për këtë vlerësim është **40 pikë**.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën. Totali i pikëve për këtë vlerësim është **60 pikë**.

6. DATA E DALJES SË REZULTATIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Burimeve Njerëzore do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail). Njësia e Burimeve Njerëzore do të shpallë fituesin në faqen zyrtare të Agjencisë, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe standat e informimit të publikut.